



Numri i lëndës: KSC-BC-2018-01

Vendosi: Paneli i përbërë prej Gjykatësit të Vetëm
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 17 tetor 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*

Urdhër për Transferimin e Dokumenteve

Ushtguesit të Detyrës së Zëvendësprokurorit të Specializuar

Vard Ferdinandse

Administratore

Fidelma Donlon

GJYKATËSI I VETËM,¹ në bazë të nenit 33(2) të Ligjit nr. 05/L-53 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, lëshon këtë urdhër.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 11 shtator 2023, Kryetarja e Dhomave të Specializuara vendosi të caktonte gjykatësin Nikola Giju si Gjykatës të Procedurës Paraprake në lëndën KSC-BC-2023-10,² në vijim të njoftimit nga Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") për dorëzimin e aktakuzës kundër Sabit Januzit dhe Ismet Bahtjarit ("të akuzuarit").³

2. Më 2 tetor 2023, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori Vendimin mbi Konfirmimin e Aktakuzës ("Vendimi i Konfirmimit"),⁴ si dhe Vendimin mbi Kërkesën për Fletarrestime dhe Urdhra të Transferimit.⁵

3. Më 5 tetor 2023, të akuzuarit u arrestuan në Kosovë⁶ dhe të nesërmen u transferuan në objektin e paraburgimit në Hagë, Holandë.⁷

¹ KSCPR-2018, F00004, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Vetëm sipas Nenit 33(2) të Ligjit*, 29 maj 2018, publik.

² KSC-BC-2023-10, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 11 shtator 2023, publik.

³ KSC-BC-2023-10, F00002/RED, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës për Konfirmim dhe Kërkesave në lidhje me Të*, 11 shtator 2023, publik, me Shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; F00016, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Versionit të Redaktuar Publik të Aktakuzës së Konfirmuar*, 6 tetor 2023, me Shtojcën 1, publike.

⁴ KSC-BC-2023-10, F00008/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës*, 2 tetor 2023, publik.

⁵ KSC-BC-2023-10, F00009/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën për Fletarrestime dhe Urdhra të Transferimit*, 2 tetor 2023, publik, me Shtojcat 1-4, rreptësisht konfidenciale.

⁶ KSC-BC-2023-10, F00011, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Ismet Bahtjarit sipas Rregullës 55(4)*, 5 tetor 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; F00012, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Sabit Januzit sipas Rregullës 55(4)*, 5 tetor 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

⁷ KSC-BC-2023-10, F00014, Administratorja, *Njoftim i Pranimi të Ismet Bahtjarit në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 6 tetor 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; F00015, Administratorja, *Njoftim i Pranimi të Sabit Januzit në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 6 tetor 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

4. Më 6 tetor 2023, Gjykatësi i Vetëm lëshoi një urdhër me të cilin udhëzoi ZPS-në të dorëzonte parashtrime lidhur me transferimin e dokumentacionit që lidhet me të akuzuarit nga dosja e lëndës KSC-BC-2018-01 në dosjen e lëndës KSC-BC-2023-10 ("Urdhër për Parashtrime").⁸

5. Më 11 tetor 2023, ZPS-ja dorëzoi parashtrimet e saj ("Parashtrimet e ZPS-së").⁹

II. DISKUTIM

6. Duke mbajtur parasysh nevojën për t'u vënë në dispozicion të akuzuarve parashtrimet e protokolluara dhe vendimet relevante në dosjen KSC-BC-2018-01 të lëshuara para Vendimit të Konfirmimit në lëndën KSC-BC-2023-10, dhe duke qenë se ZPS-ja nuk ka kundërshtime për transferimin e parashtrimeve të protokolluara që janë përfshirë në listën e Urdhrit për Parashtrime,¹⁰ Gjykatësi i Vetëm urdhëron Zyrën Administrative t'i transferojë dokumentet e renditura më poshtë në dosjen e lëndës KSC-BC-2023-10. Urdhri për Parashtrime (KSC-BC-2018-01, F00473, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*), Parashtrimet e ZPS-së (KSC-BC-2018-01, F00477, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*), si dhe ky urdhër, së bashku me parashtrimet e protokolluara të renditura nën këtë paragraf, së bashku me Shtojcat dhe përkthimet përkatëse, nëse ka, duhet të bashkëlidhen dhe transferohen në dosjen e lëndës KSC-BC-2023-10 si në vijim: (i) Urdhri për Parashtrime, Parashtrimet e ZPS-së dhe ky urdhër duhet të transferohen të parët, sipas kësaj renditjeje, dhe duhet të vendosen pas parashtrimit të protokolluar më të fundit në dosjen e lëndës KSC-BC-2023-10; dhe (ii) dokumentet e renditura më poshtë duhet të vijnë menjëherë pas tij, në rend

⁸ KSC-BC-2018-01, F00473, Gjykatësi i Vetëm, *Urdhër për Parashtrime në lidhje me Transferimin e Dokumenteve*, 6 tetor 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

⁹ KSC-BC-2018-01, F00477, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë në bazë të Urdhrit F00473*, 11 tetor 2023, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

¹⁰ Urdhër për Parashtrime, para. 4; Parashtrimet e ZPS-së, para. 2.

kronologjik. Nëse nuk urdhërohet ndryshe, këto dokumente duhet të ruajnë klasifikimin aktual.

- i. KSC-BC-2018-01, F00333, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*;
- ii. KSC-BC-2018-01, F00337, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*;
- iii. KSC-BC-2018-01, F00335, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*;
- iv. KSC-BC-2018-01, F00342, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-2, rreptësisht konfidenciale;
- v. KSC-BC-2018-01, F00345, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*;
- vi. KSC-BC-2018-01, F00348, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale;
- vii. KSC-BC-2018-01, F00351, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*;
- viii. KSC-BC-2018-01, F00355, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale;
- ix. KSC-BC-2018-01, F00356, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*;
- x. KSC-BC-2018-01, F00359, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*;
- xi. KSC-BC-2018-01, F00366, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*;
- xii. KSC-BC-2018-01, F00368, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-4, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*;
- xiii. KSC-BC-2018-01, F00372, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*;
- xiv. KSC-BC-2018-01, F00377, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*;

- xv. KSC-BC-2018-01, F00378, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*;
- xvi. KSC-BC-2018-01, F00383, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*;
- xvii. KSC-BC-2018-01, F00387, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*;
- xviii. KSC-BC-2018-01, F00394, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale;
- xix. KSC-BC-2018-01, F00395, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale;
- xx. KSC-BC-2018-01, F00396, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*;
- xxi. KSC-BC-2018-01, F00406, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*;
- xxii. KSC-BC-2018-01, F00411, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*;
- xxiii. KSC-BC-2018-01, F00412, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*;
- xxiv. KSC-BC-2018-01, F00415, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*;
- xxv. KSC-BC-2018-01, F00416, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*;
- xxvi. KSC-BC-2018-01, F00418, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-2, rreptësisht konfidenciale;
- xxvii. KSC-BC-2018-01, F00421, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*;
- xxviii. KSC-BC-2018-01, F00422, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale;
- xxix. KSC-BC-2018-01, F00424, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*;
- xxx. KSC-BC-2018-01, F00429, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcën 1;

- xxxi. KSC-BC-2018-01, F00440, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*;
- xxxii. KSC-BC-2018-01, F00449, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale;
- xxxiii. KSC-BC-2018-01, F00454, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*;
- xxxiv. KSC-BC-2018-01, F00459, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-2, rreptësisht konfidenciale; dhe
- xxxv. KSC-BC-2018-01, F00465, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

7. Më tej, duke mbajtur parasysh faktin se hetimet po vazhdojnë si dhe faktin se ZPS-ja nuk ka kundërshtime as në lidhje me këtë aspekt,¹¹ Gjykatësi i Vetëm urdhëron ZPS-në të bëjë protokollim të dyfishtë të parashtrimeve të ardhshme që lidhen me hetimet në kryerje e sipër të të akuzuarve, përfshirë të raporteve dhe/ose kërkesave të ardhshme që mund të vijnë si rezultat i parashtrimeve të protokolluara të renditura në paragrafin më sipër, si në dosjen e lëndës KSC-BC-2018-01 ashtu edhe në dosjen e lëndës KSC-BC-2023-10. Gjykatësi i Vetëm thekson gjithashtu se çdo protokollim i ardhshëm në dosjen KSC-BC-2018-01 që do të protokollohet në dosjen KSC-BC-2023-10, duhet të ruajë, në parim, klasifikimin origjinal, përveç nëse ZPS-ja informon ndryshe.

¹¹ Parashtrime të ZPS-së, para. 3.

III. VENDIM

8. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- (a) **URDHËRON** Zyrën Administrative të kopjojë dhe transferojë, në mënyrën e përcaktuar në paragrafin 6 të këtij urdhri, dokumentet e renditura në të, **deri të premten, 20 tetor 2023;**
- (b) **URDHËRON** Zyrën Administrative të ruajë nivelin aktual të klasifikimit të çdo dokumenti të kopjuar dhe transferuar, përveç nëse urdhërohet ndryshe; dhe
- (c) **URDHËRON** ZPS-në që të kryejë protokollim të dyfishtë, siç përshkruhet në paragrafin 7 të këtij urdhri, të parashtrimeve të ardhshme që lidhen me hetimet në kryerje e sipër në lidhje me të akuzuarit.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatës i Vetëm

E martë, 17 tetor 2023

Në Hagë, Holandë